



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 02-062/01-4/2020 dt. 16/29/ 2025

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z.Bekim Lestrani, më datë: 25.09.2025 (e enjte) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të këtë


Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal i mbajtur më datën 30.07.2025;
2. Draft Buxheti i Komunës për vitin 2026 dhe projeksionet për vitet 2027-2028;
3. Raporti i progresit për Implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2024.
4. Të ndryshme.

Drenas, 16.09.2025



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Bekim Lestrani



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-40960 dt. 16/09/ 2025

PROCESVERBAL

I mbledhjes së shtatë të rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit, mbajtur më 30.07.2025, e cila filloi në orën 10:00.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani dhe deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 29 anëtarë.

Në mbledhje morën pjesë: Kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani (PDK), Labinot Halilaj (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri - Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Valentina Leku (PDK), Manushaqe Mulaku (PDK), Kosovare Halilaj- Karaxha (PDK), Sali Dvorani (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Egzona Terdevci (VV), Filloreta Bujupi (VV), Selman Qallapeku, Arbër Halilaj (GREEN), Egzon Qorri (LDK), Muhamet Kurtaj, Mirlinda Dvorani, Florentina Elezi-Veliu.(VV).

Munguan: Mergim Pirraku(DD), Qendrim Mulaj(PDK).

Të pranishëm ishin edhe: Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, Arben Shala nënkryetar i Komunës së Drenasit dhe drejtor të drejtorive komunale.

Mbledhja do të këtë

Rend dite:

1. Procesverbalin e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, mbajtur më 30.06.2025;
2. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të auditimit dhe pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Drenasit për vitin 2024;
3. Raporti i punës së Kryetarit dhe qeverisjes lokale janar-qershor 2025;
4. Raporti financiar janar-qershor 2025;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, pasi prezantoi rendin e ditës, meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime, kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent ishin 20 anëtarë të Kuvendit, rendi i ditës kaloi në mënyrë unanime pa ndryshime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e parë të rendit të ditës: 1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit, të dt. 30.06.2025. Pasi nuk pati vërejtje diskutime apo sugjerime, kryesuesi hodhi në votim pikën e parë të rendit të ditës, e cila kaloi me vota unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 2. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të auditimit dhe pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Drenasit për vitin 2024.

Egzona Terdevci, unë i kam disa pika që dua me u fokusin të raporti i auditimit. Gjetja kryesore e raportit të auditimit, unë e di që Ministria e Financave ju ka propozu të gjitha komunave me ndarë një kod në mënyrë që mos me pagu ekstra shpenzime të përmbarimit edhe të gjykatave, a keni mendu diçka në këtë drejtim në mënyrë që të paktën shpenzimet ekstra mos me i pagu.

Gjithashtu dy vërejtje shqetësuese janë, mungesa e projekteve ekzekutuese dhe dhënia e tenderëve pa plotësim të kriterëve. Ne e kemi ditë që tenderët jepën për njerëz që e mbështesin Kjetarin gjatë fushatës, po është mirë që është e evidentueme edhe në raport të auditimit që tenderët janë dhënë pa i plotësu kriteret. Po ashtu z. Lladrovci njëherë prej vërejtjeve e kemi mos raportimin për dhënie e pronave në shfrytëzim të pronave publike vëtem një herë që katër vjet me kërkesën e asambleistëve. Ne sot e kemi si pikë të rendit të ditës raportin për gjashtëmujorin e qeverisjes tënde e në këtë është dashtë me qenë edhe raporti për pronat publike nuk është kështu që spo di pse e keni qit që është i zbatuar ky rekomandim kur nuk e ke të përfshirë raportin për prona në gjashtëmujorin tënd.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, keq klasifikimi buron prej qeverisë së Kosovës, sepse të gjitha mjetet që na i ka marrë, jo vetëm neve por të gjitha komunave të Kosovës për shkak të kontratës kolektive. Qeveria ka për obligim me i dhënë ato mjete dhe mos me na marrë prej investimeve kapitale, sepse për këtë arsye shumë projekte mbesin pa u përfundu.

Sa i përket kodit buxhetor, ne kemi kërku disa herë kod për me mund me i pagu mjetet

për projekte, e sa i përket raportimit unë raportojë, sepse ligji më obligon jo pse kërkon t'i, asnjë tender nuk e kemi dhënë pa kriter.

Egzona Terdevci, kryesues është shumë shqëtesuese që t'i nuk reagon ndajë gjuhës ofenduese të Kryetarit vetëm për asambleist, por jo edhe për Kryetarin, kjo le të mbetet vërejtje në procesverbal që t'i nuk e respekton rregulloren dhe lejon që Kryetari me i ofendua asambleistat.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, nuk ke asnjë ofendim e nderuar.

Egzona Terdevci, i pyesim edhe asambleistët a ke a nuk ke ofendim. Sa i përket kontaktave kolektive nuk janë nënshkrua prej Qeverisë Kurti, e dini edhe ju por po doni me i përdor për diskurs publik këto kontrata kolektive, janë nënshkruar e arsimit prej Ramë Likes, e shëndetësisë prej Uran Ismailit, Ministrisë të PDK-së. Qeveria Kurti i ka ndaluar në 2022-tën, pasi e ka kontrolluar bazën ligjore nuk është e vërtetë ajo fjala jote që po don me i lanë pa parë për dritë e sene tjera keni pas mundësi me i bllokuar mjetet e rezervave nuk dini me menaxhu me mirë nuk ju ka faj askush as Qeveria as askush tjetër dhe vërejtjen për mos raportim të pronave e keni në raportin e auditimit, lexojë raportin e auditimit aty e ke vërejtje.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën e dytë të rendit të ditës prezent ishi 28 anëtarë, me 23 vota për, 0 kundër, 5 abstenim, kaloi pika e dytë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e tretë 3. Raporti i punës së Kryetarit dhe qeverisjes lokale janar-qershor 2025, meqenëse pika e tretë është raport dhe nuk votohet vazhdojmë me pikën e katërt.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 4. Raporti financiar janar-qershor 2025.

Egzona Terdevci, në faqen dy të raporti financiar të komunalit thuhet se shpenzimet e komunalive janë rritë për shkak të shtrenjimit të energjisë shumë e rritur siaps juve në raport qysh e keni shkruar është 25 mijë 881 euro, ndërkaq në të njëjtën fjalë as nuk ndërprehet fjalja thuhet se 24 mijë e 100 euro, janë paguar për shpenzimet përmbartimore pra nuk qëndron pjesa që janë ngrit shpenzimet për shkak që u ngrit energjia sepse diferenca është 1700 euro dhe në faqen 4 të të hyrat nga ndërrimi i destinimit të tokës janë 56 mijë 436 euro 75 cent, a mundemi me ditë se cilav parcela ju është ndërruar destinimi edhe për mu është shqëtesuese rritja kaq e madhe e vlerës ndërrimit të destinimit të tokave a jemi duke humbur toka bujqësore tuj u shëndërruar në toka ndërtimore me këto ndryshime.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ngritja e shpenzimit të energjisë elektrike ndikon kur shtohet ndriqimi nëpër fshatra por ndoshta edhe për shkak të shtrenjimit të energjisë elektrike.

Drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit Petrit Gashi, tha se e kam sqaruar edhe një herë së rritja e ndërrim destinimit të tokës vjen si rezultat i hartave të reja zonale dhe zonave të ndërtimit, pra shumë zona ndërtimi kanë qenë bujqësore p.sh brenda në Drenas ato toka bujqësore duhet me u kthyer në zona ndërtimore sipas ligjit është kategoria e tokave për kthimin e tokave prej tokës bujqësore në tokë ndërtimore, pra i kemi edhe hapsirat tjera të shëbimeve tregtare për gjatë autostradës Ibrahim Rugova d.m.th të zgjerimi i tokave ndërtimore ku dhe atyre tokave duhet të u bëhet ndërrim destinimi i tyre aty ku nuk ka komostacion.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e pestë 5.Të ndryshme.

Egzona Terdevci, e kam një pyetje për drejtorin i Infrastruktues Endrit Gllareva kam biseduar me të para disa ditëve dhe me kërkesë të disa bizneseve të rruga e zejtareve lidhur me bllokimin e rrugës Fehmi Lladrovci ju e dini që ato biznese janë dëmtu edhe në vitin e kaluar për shkak të ndërtimit në shesh dhe bllokimit të qasjes së rrugës me keni premtuar në telefon që për të hënë ka me u hap rruga dhe ende nuk është hap. Dhe pyetje për rrugën Valdet Xhemajli në Poklek janë tri shtylla që janë vendos me financim vetanak nga banoret aty kur mundet me u vendos ndriqimi publik në atë pjesë.

Drejtori i Drejtorisë së Infrastruktues Endrit Gllareva, ashtu siq kemi bisedu në telefon për shkak të ndalesës së orarit të punës nga ora 11 deri 15 nga Ministria e Shëndëtesisë janë shtyrë edhe disa afate të relazimit të punimeve deri në fund të kësaj javë do të lëshohet rruga Fehmi dhe Xhevë Lladrovci.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, unë e kam me shumë për qytetar jo për juve kur thuhet është e pa ndershme me i pengu bizneset ndërkohë që ne po bëjm një projekt i cili ja rrit vlerën edhe vet biznesit, ne ju kemi kërku falje krejt bizneseve për projektet që e i kemi zhvillu dhe vazhdojmë me ju kërku falje bizneseve nese jemi vonu në projekte, por asnjëherë nuk e keni ngrit zërin e me thanë që ato biznese e kanë shfërtëzu pronën publike ende pa u përfundu punimet në shesh janë zënë hapsira të mëdha të sheshit e që me ligj nuk kanë të drejt as qytetaret me lëvizë në punishte. Sa i përket ndriqimit do të bëjm në të gjitha lagjet duke filluar nga ato lagjet me të mëdha deri të ato me të vogla.

Egzona Terdevci, shtyllat janë të vendosura me financim vetanak krejt qka i duhet është me u dërgu ndriqimin punbluk nuk bëhet fjalë për shtëpi të reja është lagje që ka qenë ekzistente me heret po ju e keni vendos ndriqimin deri ku ka pasë shtyllë betoni e kuptoi atë pjesë. Sa për pjesën e nxenjes së hapsirave publike t'i je Kryetar merru me këto çështje sepse ne nuk mundemi me ditë saktë cilat janë hapsirat publike.

Beqir Kiqina, sa i përket rrugës Ragip Halilaj drejtuar Drejtorisë për Shërbime Publike respektivisht drejtorit Nexhmedin Gruda ku edhe me herët kam pas kërkesa sepse në këtë rrugë ka pasë shumë prerreje dhe është një gjendje të mjerueshme, a ke dal kohëve

të fundit me shiqu në qfarë gjendje po përballemi ne sidomos që e frekuentojme atë rrugë, të lutem që sa më parë me marrë masa sepse operatori ekonomik e ka prerë në dhjetra vende për të njejtën rrugë kam bërë disa herë kërkesë .

Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Nexhmedin Gruda, në vitin e kaluar ne si drejtori kemi bërë një renovim të gropave në atë rrugë, ndërsa këtë vit buxhetin e kemi shpënu në rruget që janë në gjendje me të keqe se ajo rrugë për momentin na kan mbet rruga në Likoshan dhe rruga për në Komoran 3 që janë në gjendje edhe me të keqe së rruga Ragip Halilaj, mirëpo me mundësi buxhetore e realizojmë edhe atë kërkesë.

Beqir Kiqina, nuk bëhet fjalë këtu për mundësi buxhetore janë dhjetra metra nuk po folum për qindra metra por dhjetra metra rruga ka nevojë për riparim sa me shpejt që është e mundur, është e vërtet që ju keni ndërhy por tani është gjendja edhe me e keqe.

Marigona Bazaj, si ka mundësi që dy doktorët në pediatri kan shkuar në pushim vjetor në të njejtën kohë.

Drejtoresha e shëndetësisë Lumnije Krapi, unë nuk e besoj që dy pediatret janë në pushim mjekësor por do të marr masa dhe do të shikojë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, as me ligj as me dëshir nuk ka mundësi që dy mjek pediatric me shku në pushim vjetor mundet të jet njani që është smut me pas aksident por besoj që duhet me u sqaruar me mirë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, pasi nuk pati pyetje as diskutime tjera të pika të ndryshme e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Më gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit, të dt. 30.07.2025 mund ta ndiqni në ueb faqen zyrtare të Komunës, në rrjetin social.

<https://ëëë.facebook.com/share/v/16yR6AmGyD/>

Mbledhja përfundoi në ora 11:10.

Procesmbajtësja



Fakte Hoti

Lekturoi


Nikelinda Bujupi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Bekim Lestrani

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		16/09/2025	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-400101-41088			



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria-Vlada-Government
Komuna/Opstina/Municipality Drenas (Gllogoc)
Zyra e Kryetarit



DRAFT
BUXHETI I KOMUNËS PËR VITIN 2026 DHE
DHE PROJEKSIONET PËR VITET 2027 - 2028

Drenas, shtator 2025

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 dhe 40 pika 40.2 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 61 të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 34 pika 34.6 nën (b) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës, propozon:

DRAFT
BUXHETI I KOMUNËS PËR VITIN 2025 DHE PROJEKSIONET PËR VITET
2026- 2027

Neni 1

Më këtë Drafthet, Buxheti i Komunës së Drenasit për vitin 2026 si dhe projektionet për vitet 2027- 2028.

Buxhetit për vitin 2026 miratohet në shumë prej: **23,734,533.00** euro, si dhe projektionet:

- Për vitin 2027 në shumë prej: **24,949,698.00** euro dhe
- Për vitin 2028 në shumë prej: **26,143,011.00** euro.

Neni 2

Të hyrat e Buxhetit të Komunës, planifikohen të realizohen nga dy burime:

- Grantet e Qeverisë dhe nga
- Të hyrat Vetanake .

Komuna gjatë viteve në vijim, mund të realizoi mjete nga donacionet dhe participimi i qytetarve dhe huamarrja. Mjetet nga donacionet, participimi dhe huamarrja, do të jenë pjesë të këtij buxheti dhe do ndikojnë në rritjen e buxhetit, varësisht nga viti që do të ndodhë. Rritja e buxhetit do të bëhet, vetëm kur mjetet të paguhen në xhirollogarinë e Komunës.

Neni 3

Të hyrat e buxhetit të komunës planifikohet të realizohen si vijon:

Të hyrat sipas sektorve	Buxheti	Projeksionet	
	2026	2027	2028
Spektori i Administratës	10,162,859.00	11,445,734.00	12,466,502.00
Spektori i Arsimit	10,659,134.00	10,493,893.00	10,605,352.00
Spektori i Shëndetësisë	2,912,540.00	3,010,071.00	3,071,157.00
Gjithsej të hyrat:	23,734,533.00	24,949,698.00	26,143,011.00

Neni 4

Shpenzimet për vitet 2026-2028 aprovohen për 20 programe – nënprograme buxhetore në nivel komunal, dhe në pesë (5) kategori kryesore ekonomike të si vijon:

Buxheti për vitin 2026

Programet:	Staf 2026	Paga dhe Shtesa	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione	Investimet kapitale	Gjithsej:
Zyra Kryetarit	21	238,140	98,600		25,000		361,740
Administrata	42	349,048	169,290			100,000	618,338
Inspekcioni	10	107,818	28,910				136,728
Zyra e Kuvendit	27	294,453	20,250				314,703
Buxhet dhe Financa	17	147,219	22,070				169,289
Shërbime Publike	26	261,616	428,550	251,150	110,000	35,000	1,086,316
Infrastrukturë Publike	9	88,986	14,000			4,905,220	5,008,206
Zyra për Komunitete dhe Kthim	1	12,113	870				12,983
Bujqësia dhe zhvillimi rural	7	65,622	11,000		82,500		159,122
Gjeodezia, kadastra dhe prona	13	103,213	8,550				111,763
Planifikimi Urban	9	83,444	44,070				127,514
Zhvillimi ekonomik	8	79,526	35,250		68,000		182,776
Kultura, Rinia dhe sporti	13	110,272	101,200		130,000	462,000	803,472
Administrata e Shëndetësisë	5	50,353	8,540		100,000		158,893
QKMF	209	2,206,160	528,780	57,600		120,000	2,912,540
Qendra për punë sociale	14	139,122	24,800	11,100	8,000	230,000	413,022
Administrata Arsim	12	125,604	277,340		95,050		497,994
Arsimi parafillor	42	303,855	85,000	10,000			398,855
Arsimi fillor	735	6,647,858	572,884	60,000	124,950	1,022,918	8,428,610
Arsimi i mesëm	174	1,709,053	106,616	16,000			1,831,669
Gjithsej	1394	13,123,475	2,586,570	405,850	743,500	6,875,138	23,734,533

Projeksioni për vitin 2027

Programet:	Staf 2027	Paga dhe Shtesa	Mall dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione	Investime Kapitale	Gjithsej:
Zyra Kryetarit	21	239,331	111,420		25,500		376,251
Administrata	42	350,793	189,849				540,642
Inspekcioni	10	108,357	32,270				140,627
Zyra e Kuvendit	27	296,088	42,470				338,558
Buxhet dhe Financa	17	147,955	22,070				170,025
Shërbime Publike	26	262,924	436,100	258,150	110,000	40,000	1,107,174
Infrastrukturë Publike	9	89,431	14,000			5,959,158	6,062,589
Zyra për Komunitete dhe Kthim	1	12,174	890				13,064
Bujqësia dhe zhvillimi rural	7	65,950	16,170		90,000		172,120
Gjeodezia, kadastra dhe prona	13	103,729	8,600				112,329
Planifikimi Urban	9	83,861	98,770				182,631
Zhvillimi ekonomik	8	79,924	39,120		100,000		219,044
Kultura, Rinia dhe sporti	13	110,823	101,200		100,762	492,000	804,785
Administrata e Shëndetësisë	5	50,605	7,500		100,000		158,105
QKMF	209	2,217,191	585,280	57,600		150,000	3,010,071
Qendra për punë sociale	14	139,818	23,300	11,100	6,000	200,000	380,218
Administrata Arsim	12	126,232	441,340		100,000		667,572
Arsimi parafillor	42	305,211	90,000				395,211
Arsimi fillor	735	6,681,097	585,273	60,000	124,950	803,651	8,254,971
Arsimi i mesëm	174	1,717,598	110,113	16,000			1,843,711
Gjithsej	1394	13,189,092	2,955,735	402,850	757,212	7,644,809	24,949,698

Projeksioni për vitin 2028

Programet:	Staf 2028	Paga dhe Shtesa	Mallra dhe Shërbime	Shërbime Komunale	Subvencione	I.Kapitale	Gjithsej:
Zyra Kryetarit	21	240,527	102,740		20,000		363,267
Administrata	42	352,547	184,240				536,787
Inspekcioni	10	108,899	31,830				140,729
Zyra e Kuvendit	27	297,733	25,800				323,533
Buxhet dhe Financa	17	148,695	22,070				170,765
Shërbime Publike	26	264,239	417,553	265,200	115,000	220,000	1,281,992
Infrastrukturë Publike	9	89,878	14,000			6,860,000	6,963,878
Zyra për Komunitete dhe Kthim	1	12,234	920				13,154
Bujqësia dhe zhvillimi rural	7	66,280	16,370		78,950		161,600
Gjeodezia, kadastra dhe prona	13	104,248	8,650				112,898
Planifikimi Urban	9	84,281	99,970				184,251
Zhvillimi ekonomik	8	80,323	41,270		70,000		191,593
Kultura, Rinia dhe sporti	13	111,377	80,200		100,000	522,000	813,577
Administrata e Shëndetësisë	5	50,858	7,500		100,000		158,358
QKMF	209	2,228,277	585,280	57,600		200,000	3,071,157
Qendra për punë sociale	14	140,517	23,300	11,100	6,000	200,000	380,917
Administrata Arsim	12	126,863	442,340		100,000		669,203
Arsimi parafillor	42	306,573	95,000				401,573
Arsimi fillor	735	6,714,503	592,832	60,000	124,950	858,196	8,350,481
Arsimi i mesëm	174	1,726,185	111,113	16,000			1,853,298
Gjithsej	1394	13,255,037	2,902,978	409,900	714,900	8,860,196	26,143,011

Neni 5

Shpenzimet për Paga dhe Shtesa të përcaktuara do të shpenzohen për pagimin e stafit të tre sektorëve kryesor të komunës. Në programet dhe nënprogramet buxhetore janë lejuar të financohen **1394** punëtor dhe ky numër i financimit është i përcaktuar më Qarkorën Buxhetore 2026/02, lëshuar nga Ministri i Financave Punës dhe Transfereve.

Pagat e aprovuara të stafit më këtë vendim nuk mund të rriten gjatë vitit fiskal, me përjashtim të rritjes së lejuar me vendim të Qeverisë.

Neni 6

Shpenzimet për Mallra dhe Shërbime dhe Shpenzimet Komunale për vitet 2026-2028, janë të planifikuara dhe aprovuara, sipas programeve-nënprogrameve buxhetore për plotësimin e nevojave gjatë viteve, por gjithnjë duke pasur parasysh mundësinë e kursimeve.

Neni 7

Mjetet e dedikuara për Subvencione dhe Transfere do të shpenzohen për projekte të ndryshme për të cilat programet dhe nënprogramet kanë paraqitë kërkesat e tyre, dhe do të shpenzohen në bazë të kriterëve të përcaktuara, dhe dispozitave ligjore dhe rregullave të përcaktuara nga Departamenti i thesarit –MFPT .

Neni 8

Shpenzimet për Investime Kapitale do të shpenzohen sipas projekteve të aprovuara nga Kuvendi i Komunës dhe Kuvendi i Kosovës dhe të regjistruara në programin e PIP-it.

Pjesë e këtij vendimi është edhe Lista e Projekteve Kapitale për tri vite (2026-2028).

Neni 9


Buxheti i aprovuar për vitet 2026-2028 është bazuar në Qarkoret Buxhetore 2026/01 dhe atë 2026/02 për komunat lëshuar nga Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve.

Neni 10

Ky vendim i buxhetit, hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës dhe për zbatimin e tij do të kujdesen; Kryetari i Komunës si dhe Menaxheret e programeve –nën programeve- mbajtësit e buxhetit, ndërsa së aplikuari fillon nga 1 Janari 2026.



KRYETARI I KOMUNËS


Ramiz Lladrovci



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E DRENASIT
ZYRA E KRYETARIT
01 NR052101-40883 DT. 15/09/ 2025



Për: Zyra Kombëtare e Auditimit, znj. Viora Spanca

Nga : Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Drenasit



Lënda: Raporti I progresit për Implementimin e rekomandimeve të ZKA-së, për Vitin 2024.

Në pajtim me nenin 14 të Rregullores së punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit, si dhe duke u mbështetur në Procedurat Standarde të Trajtimt të Rekomandimeve të Zyres Kombëtare të Auditimit , po ju dërgojmë Raportin e progresit për implementimin e Rekomandimeve që dalin nga “Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Drenasit për vitin 2024 ”

Çështja	E gjetura	Rekomandimi	Vepimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete ne lidhje me zbatim te rekomandimit	Statusi I rekomandimit(I zbatuar,pjeserisht I zbatuar ose I pa zbatuar)	Sfidat e hasura në zbatimin e rekomandimit
Çështja B1- Keq klasifikim I shpenzimeve	Nenit 18, paragrafi 3 e Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë Janë vrejtur keq klasifikime te shpenzimeve nper kategori ekonomike ne vlere 2,488.200€.Nga Kjo vlere thesari kishte paguara sipas urdherva përbarimor per zbatimin e kontrates kolektive bga kategoria e investimeve kapitale 1,879,133€ dhe sherbimeve Komunale 27,849€ Pagesat për paga jubilare dhe shujta kanë ndodhur si rezultat I kontratës kolektive,shpenzimet e të cilave nuk kanë mundur të planifikohen me buxhet.	Kryetari duhet të siguroj që janë ndermarrë të gjitha veprimet qe shpenzime te planifikohen ne ndarjet adekuate te bushtetit(apo te rdestinohen njiyet kur eshte e nevojshme dhe e mundeshme)dhe qe pagesa e regjistrimi I shpenzimeve behet sipas kodeve ekonomike	Komuna ka vazhduar të kerkoj dhe insistoje tek niveli qendror qe te gjejne zgjidhje, shtim të masës buxhetore për këtë kategori të shpenzimeve nga Ministria e Financave, meqense shpenzimet që kanë dal nga kontratat kolektive-sektoriale, me qarkore buxhetore nuk mund të buxhetohet.	I Pa zbatuar	Pamundësia për të buxhetuar nga buxheti i Komunës.
Çështja A1 - Nënvlërësimi i pasurive nën 1,000€	Rregulloja MF-Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 6.1. përcakton se, "Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj.	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme lidhur me	Janë regjistruar ne sistemin e-pasuria dhe pranuar ne regjistrin kontabel ne e-pasuri.	I Zbatuar	

	Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Po ashtu neni 6.3. përcakton se: Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria". Në regjistrin e pasurive jo financiare nën 1,000€, kemi vërejtur pasuri të blera në vitin 2023 dhe 2024 për 117 njësi për tabela të mençura me vlerë 112,203€, nuk ishin regjistruar në regjistrin e-pasuria që rezulton në nënvlerësimin e regjistrit të pasurive jokapitale. Kjo ka ndodhur si rezultat i kontroleve të dobëta në monitorimin dhe verifikimin e regjistrave të pasurisë	regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare në pajtim me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.			
Çështja A2- Vonesa në lëshimin e lejeve ndërtimore.	Neni 17(pika 1.2)I Ligjit të Ndërtimi thotë;"Leja ndërtimore lëshohet nga organi kompetent Brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkeses për leje ndërtimore për kategorinë I dhe dyzet e pesë (45) ditë për kategorinë e II dhe III. Në dy (2) raste ka vones në lëshimin e vendimeve për lejet ndërtimore sipas afatit ligjor nga ana e Komunes pas pranimit të kërkeses për leje ndërtimore. Vlera totale e keqyre mostrave është 100,610€,kurse vonesat	Kryetari duhet të sigurojë që të respektohen afatet ligjore për lëshimin e lejeve ndërtimore, duke forcuar kontrollin e brendshëm dhe mbikëqyrjen mbi trajtimin e kërkesave, në mënyrë që të	Komuna është duke ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që të respektohen afatet ligjore në mënyrë që mos të ketë vonesa në lëshimin e lejeve të ndërtimit. Nëse nuk sillen me kohë dokumentacionet e nevojshme për marrjen e lejes së ndërtimit si : -Pëlqimi për rregullim të dokumentacionit teknik	Pjesërisht	Vonesa në kompletimin e dokumentacionit marrja e pëlqimeve (AME, MMPHI, KEDS, Ujesjelles, çështja e pronshore)

	ne leshimin e lejeve ndertimore jane deri 220 dite. Kjo ka ndoshur për arsye të mosfunksionimit efektiv të kontrolleve të brendshme dhe vonesat në pëlqimin nga KEDS-I për kompletimin me kohë të dokumentacionit.	mundësohet mbledhja me kohë e të hyrave	nga kompania e KEDS-it, -Pëlqim për kushte teknike nga Kompania Ujësjellësi Rajonal Sh.A. "Pristina", -Pëlqim në dokumentacionin investivo-teknik mbi masat e parapara për mbrojtje nga zjari nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent, -Pëlqim për kyqje në rrugë Nacionale (Magjistrale), Regionale dhe Autoudhë, nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, Zyrtarët nga DUMM do të detyrohen të kryejnë procedurat për refuzim të lëndës sipas ligjeve në fuqi.		
Çështja A3 – Shpërblimi më kontratë në	Ligji i prokurimit publik Neni 59 paragrafi 4 parasheh: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në	Zyra e prokurimit ka marrur masa dhe është shtuar kontrolli i nevojshem per vlersimin	Pjesërisht I Zbatuar	Volumi I madh I punës, staf ne numer I vogel, projektet e

mungesë të plotësimit të kriterëve të vendosura në dosjen e tenderit	fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, rregulloja 001/2022 për prokurimin publik neni 28.7 parashihet: Afati i fundit për dorëzimin e sigurimit të tenderit do të jetë i njëjti si ai për dorëzimin e tenderëve. Sigurimet e tenderëve të pranuar pas afatit për dorëzimin e tenderit do të refuzohet dhe kështu do të rezultojë në refuzimin e tenderit. OE te shperblyer me kontrate ne mungese te plotesimit te kerkesave te njoftimit per Kontrate dhe dosje te tenderit po i parqesimi rastet si ne vijim • Te kontrate per “ndertimin ,zgjerrimin dhe rikonstruimin i rrugeve te asfaltuara ne Drenas-projekt dy vjeqar(Rruges tre -Kater korsi(Rikonstruimi)Rruga Fehmi dhe Xheve Lladrovci),ne vlere te tenderit ne kerkesen per pershtatshmeria profesionale pika 6 jane kerkuar raportet e auditimit per tri vitet e fundit 2023,2022 dhe 2021 ndersa operatori ekonomik ne oferten e tij ka parqitur raportet e rishikimit te pasqyrave financiare vjetore; dhe	fushën e prokurimit, në mënyrë që vlerësimi i ofertave të bëhet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e vendosura në dosjet e tenderit dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. Po ashtu, përmes zyrtarëve përgjegjës të sigurojë se anëtarët e komisioneve i kuptojnë detyrat dhe përgjegjësitë ne procesin e vlerësimit të ofertave përkatëse dhe në rast të gabimeve eventuale këto të evidentohen nga zyrtarët e	e procedurave te prokurimit .		natyrave të ndryshme
--	--	---	-------------------------------	--	----------------------

	• Te kontrate per “Ndertimi i aneksit te SHFMU Rilindja”ne Dobreshec ne vlere te kontraktuar 26,978€,operatori ekonomik fitues ne oferten e tij nuk ka dorezuar sigurin e tenderit Kjo ka ndoshur si pasojë e mungesës së funksionimit të kontrolleve të brendshme, në fushën e prokurimit.	prokurimit para nënshkrimit të raportit të vlerësimit.			
--	--	--	--	--	--

ÇËSHITJA A4 – REALIZIMI I ARTIKUJVE TË KONTRATËS ME ÇMIM PËR NJËSI, JO NË PËRPUTHJE ME PESHËN E PËRCAKTUARA NË DOSJE TË TENDERIT DHE PRANIMI I SHËRBIMEVE TË PAARSYETUARA	Bazuar në nenin 54.15 të Rregullores 001/2022 dhe interpretimit të KRPP- së të datës 09.06.2023 parasheh: “Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dinë sasitë indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshat në bazë të rëndësisë së secilës “kategori të shërbimeve” ose secilit “artikull” në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo taverani plus/minus tridhjetë për qind (30%), në këto raste në hapije publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi dhe mund të realizohet deri në vlerë të parashikuar”. Duke pasur parasysh faktin se peshimi i artikujve duhet bërë duke u bazuar në peshën dhe në rëndësinë e çdo artikulli , kjo nënkupton që vlera dhe sasia e realizuar (shpenzuar) e artikujve nuk mund të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë fillimisht në dosjen e tenderit dhe Rregulloja 01/2013/MF- Për shpenzimin e parasë publike, Neni 24, paragrafi 1.2 parasheh: të siguroj raportin e pranimit të mallit/shërbimit nga zyrtari / komisioni i autorizuar. Kontrata publike kornizë me çmim njësi”Nbështetje profesionale me komponentin e mirëqenies sociale dhe shërbimit publik për qytetaret e komunës së Drenasit”kornizë trevjegare me cime për njësi për artikull	Kryetari duhet të sigurojë se menaxhimi i kontratës nga menaxheri i kontratës bëhet në pajtim me kërkesat ligjore, në mënyrë që kontrata publike kornizë me çmim për njësi të realizohet në pajtueshmëri të plotë me peshën e përcaktuar në dosjen e tenderit dhe pranimi, pagesa e shërbimeve të bëhet sipas shërbimeve reale të ndodhura.	Komuna ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që menaxhimi i kontratave të bëhet në pajtim me kërkesat ligjore për kontratën publike kornizë me çmimin për njësi dhe të realizohet në pajtueshmëri me peshën e përcaktuar në dosjen e tenderit.	I Zbatuar	
--	---	--	--	------------------	--